

REPUBLIKA E KOSOVËS
Gjykata Themelore Pejë – Dega në Klinë
Divizioni per Kundervajtje
Rexh.I.nr. 4101/2012

DPK/DMP

03-356/2013

02

12.02.2013

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, Divizioni për Kundervajtje, në përbërje prej Gjyqtarit: Bajram Dreshaj, dhe Sek. Juridik: Galë Balija në procedurën kundërvajtëse ndaj të paraqiturit: **Izver Dauti nga fsh. Shtupel, Komuna e Klinës, sipas Akvendimit mbi Abrogimin** me të njëjtin numër, për kundërvajtje nga neni 5.6.9. dhe neni 17. të Ligjit nr.04 /L-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar, dhe neneve 30.123,195 dhe 198.al.1p. 8. të LMK-së, me datë 05.02.2013, merr këtë :

A k t v e n d i m

Pezullohet procedura kundërvajtëse konform nenit 198.al.1.p.8. të LMK-së, në mungesë të provave ndaj të paraqiturit: Izver Danush Dauti i lindur me dt. 01.02.1961, në Shtupel, ku dhe jeton Komuna e Klinës, të kryer Fak. Punëtor, i martuar, baba 3 femijeve, Këshilltar pranë Kuvendit Komunal në Klinë, gjeja i pa dënuar me parë për kundërvajtje nga neni 5.6.9. dhe 17. të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin dhe Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjith Personat Zyrtar, sepse e autorizuar - Kordinatorja: Remzije Maloku, të paraqiturit nuk ia ka dorëzuar Formularin mbi Deklarimin vjetor të Pasurisë dhe atë përmes Fletëdorzimit mbi datën e dorëzimit pranimit nga palët proceduse më nënshkrimin e dy anëshem.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka parashtruar Kerkesën nr. 01- 2171/12, të datës 15.06.2012 për zhvillimin e procedurës Kundervajtës ndaj të paraqiturit : Izver Dauti.

Veç kësaj Gjykata zhvilloj procedurën e rregullt kundërvajtëse, ku pra në procedurën e të provuarit i paraqituri : **Izver Dauti**, në mbrojtjen e vetë të sances verbale, me dt. 25.01.2013, ka vërtetuar atë se nga e autorizuar- Kordinatorja: Remzije Maloku, nuk iu është dorëzuar fare Formulari mbi deklarimin vjetor të pasurisë dhe atë përmes Fletëdorzimit mbi datën e dorëzimit pranimit të palëve proceduese dhe atë me nënshkrimin e dy anëshem.

Metutje i paraqituri deklaroi: se nese Formulari të iu kishte dorëzuar të njëjtin do ta plotësonte duke u bazuar në Ligj.

Deshmitarja: **Remzije Maloku**, në mbrojtjen e vetë të seances verbale me dt. 08.01.2013, nuk ka qenë në gjendje të vërtetoj atë që ia ka dorëzuar Formularin mbi deklarimin vjetor të pasurisë të paraqiturit: Izver Dauti dhe atë me anë të Fletëdorzimit dhe me nënshkrimin e dy palëve të pranimit dorëzimit, por se atë e kam, ,, dorëzuar në menyrë elektronike dhe me telefon,,.

Ndërsa deshmitari: **Enis Sadiku**, Perfaqësues i Agjencisë kundër Korrupsionit me Autorizimin nr. 01-155/2013, të dt. 25.01.2013, nga Departamenti ZD/DPK në Prishtinë, i cili ka vërtetuar se Formularet janë dërguar për mes postës elektronike të pikës kontaktues me të autorizuarën Ramzije Maloku.

Gjykata pas ndëgjimit të deklartës se të paraqiturit, deshmitarëve, dhe shiqimit të gjithave shkresave të tjera në lëndë, me procedimin e tyre si prova relevante dhe atyre një nga një, me lidhmerin e tyre reciproke, është vërtetuar se ato janë të mjaftshme, të besueshme dhe mjaftë bindse e konkrete, të përcaktuara për atë ku edhe në tërësi iu është falur besimi duke e **Pezulluar** procedurën kundërvajtës ndaj të paraqiturit : Izver Dauti e konform nenit 198.al.1.p.8 të LMK-së,

sipas Aktvendimit mbi Abrogimin me të njëjtin numër nga Gjykata e Lartë për Kundervajtje më marrjen e aktvendimit.

Me nga një kopje të aktvendimit të njoftohen: i paraqituri dhe parashtruesi i Kërkesës.

Këshilla Juridike

Palët e interesuara kundër këtij aktvendimi mund të ushtrojnë **Ankesë**, në afatin 8 (tetë ditor) nga dita e marrjes përmes kësaj Gjykate, për në Gjykatën Apelit në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni per Kundervajtje .

U vendos në Gjykatën Themelore Pejë- Dega në Klinë, Divizioni për Kundervajtje , me datë 05.02.2013 dhe nr.regj. 4101/2012.



Gjyqtari
Bajram Dreshaj